

**LIGJI Nr. 04/L-186  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-181 PËR INSPEKTORATIN DHE  
MBIKËQYRJEN E TREGUT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-181 PËR INSPEKTORATIN DHE  
MBIKËQYRJEN E TREGUT**

**Neni 1**

Titulli i ligjit bazik ndryshohet si në vijim: “**Ligj për Inspektoratin e Tregut**”.

**Neni 2**

Neni 1 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

**Neni 1**

1. Më këtë ligj rregullohet mbikëqyrja inspektuese e zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera në fushën e tregtisë dhe shërbimeve të brendshme dhe mbikëqyrja e tregut, detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorëve në procesin e mbikëqyrjes dhe çështjet e tjera me rëndësi për inspektoratin e tregut.

2. Mbikëqyrjen inspektuese nga paragrafi 1 i këtij neni do ta kryej inspektorati i tregut si organ i pavarur i administratës shtetërore i cili vepron në kuadër të Ministrisë përkatëse së Tregtisë dhe Industrisë.

**Neni 3**

Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafët 1.5 dhe 1.7. riformulohen me tekstin si në vijim:

**1.5. Mbikëqyrja e tregut** – formë të veçante të mbikëqyrjes inspektuese e cila përfshin aktivitetet dhe masat me të cilat sigurohet përputhshmëria e produkteve jo ushqimore në treg gjegjësisht siguria e produkteve me ligjet në fuqi.

**1.7. Dhënia e pëlqimit** - dhënien e pëlqimit nga ana e inspektorëve të tregut për plotësimin e kushteve minimale teknike për të ushtruar veprimtarinë biznesore, konform akteve nënligjore në fuqi.

#### **Neni 4**

Neni 7 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 7 Organizimi i Inspektoratit të Tregut**

Inspektorati posedon vulën e rrumbullakët dhe vulën e thatë. Forma dhe përmbajtja e vulës rregullohet me akt nënligjor.

#### **Neni 5**

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Inspektorati i tregut e kryen mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera në lidhje me:

2. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 1.nënparagrafi 1.6. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.6. mjetet matëse ligjore në qarkullim publik;

3. Neni 9 të ligjit bazik, paragrafi 1. pas nënparagrafit 1.11. shtohen nënparagrafët e rinjë 1.12., 1.13., 1.14., 1.15. me tekstin si në vijim:

1.12. markimin e efikasitetit të energjisë së pajisjeve të amvisërisë;

1.13. reklamimin e produkteve dhe shërbimeve;

1.14. çmimet (përcaktimin dhe ekspozimin e çmimeve, pagesën dhe dhënien e faturave);

1.15. kushtet për të bërë biznes në përputhje me aktet nënligjore të veçanta.

#### **Neni 6**

Neni 10 të ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Kryeinspektori përgatit raportin vjetor për punën e Inspektoratit për vitin paraprak më së voni deri në fund të muajit Janar të vitit vijues dhe të njëjtin ja dërgon Ministrit

#### **Neni 7**

Pas nenit 10 të ligjit bazik shtohet neni i ri 10.A me tekstin si në vijim :

#### **Neni 10.A**

1. Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës.

2. Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil.

## **Neni 8**

Pas nenit 11 të ligjit bazik, shtohen nenet e reja 11.A dhe 11.B me tekstin si në vijim:

### **Neni 11.A Verifikimi i produkteve**

1. Inspektorët e tregut do të bëjnë kontrollimin e karakteristikave të produkteve, përmes kontrollimit të dokumenteve (certifikatat e përputhshmërisë së produkteve, deklarimin dhe etiketimin e produktit) dhe nëse është e nevojshme të bëhet kontrollimi fizik dhe laboratorike duke u bazuar në mostrat e marruara.
2. Mostrat e produkteve do të merren konform parimit të vlerësimit të rrezikut, ankesave si dhe informacioneve të tjera.
3. Produktet të cilat vërtetohen se nuk i plotësojnë kërkesat e sigurisë dhe si të tilla paraqesin rrezik serioz, mund të shkatërrohen apo të bëhen të pa përdorshme.
4. Kur operatorët ekonomik prezantojnë raporte të testit laboratorik apo certifikatë që dëshmon konformitetin e produktit të lëshuara nga trupa të akredituara për vlerësimin e konformitetit, inspektorati i tregut do ti njeh raportet dhe certifikatat e tyre.
5. Inspektorati i tregut do të ndërmerr masat e duhura për njoftimin e shpejt të përdoruesve brenda territorit të Republikës së Kosovës, brenda periudhës kohore adekuate për rreziqet e identifikuar për produktet në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga lëndimi apo dëmtimi tjetër.
6. Kur inspektorati i tregut vendos të tërheq nga tregu një produkt të prodhuar në ndonjë shtet tjetër, ka për obligim të njoftojnë operatorin ekonomik në adresën e cila është shënuar në produkt apo në dokumentacionin shoqërues të atij produkti .
7. Vendimi për tërheqje nga tregu sipas paragrafit 6. të këtij neni, do ti komunikohet shteteve të tjera pa vonesë.

### **Neni 11.B Masat kufizuese**

1. Kur një produkt është ndaluar apo kufizuar hedhja e tij në treg, duhet të arsyetohet në mënyrë të saktë masa administrative ku është e bazuar.
2. Masat e ndërmarrura do ti komunikohen pa vonesë operatorit ekonomik.
3. Para marrjes së masës së përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, operatorit ekonomik në fjalë do ti ofrohet mundësia për tu dëgjuar brenda një periudhe të përshtatshme e cila nuk është më i gjatë se dhjetë (10) ditë , përpos në rastet kur konsultimi i tillë nuk është i mundur për shkak urgjencës së ndërmarrjes së asaj mase të arsyetuar nga kushtet e kërkuara për shëndet dhe siguri apo arsyeje tjera në lidhje me interesin publik të përcaktuar me legjislacionin relevant.
4. Nëse masa është ndërmarr pa u dëgjuar operatori, atij do ti ofrohet mundësia për tu dëgjuar sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Çdo masë e ndërmarr sipas paragrafit 1. të këtij neni, do të tërhiqet menjëherë apo do të ndryshohet, pasi që operatori ekonomik të dëshmojë se ka ndërmarr veprime efektive.

## **Neni 9**

Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Nëse subjekti i mbikëqyrur nuk eliminon parregullsitë ose nuk kryen masën e përkohshme të shqiptuar në procesin e kontrollit inspektues, inspektori i tregut mund të bëjë vulosjen (pllombimin) e objektit ky kryhet veprimtaria, deri ne eliminimin e parregullsive.

## **Neni 10**

Neni 25 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet paragrafi i ri 3. me tekstin si në vijim:

3. Përrjashtim nga paragrafi 2. i nenit 25 të ligjit bazik, pagesa e shpenzimeve të mostrave të marruara për testim, kryhet nga subjekti i mbikëqyrur, në ato raste kur testimi i produkteve apo monitorimi i tregut për produkte të caktuara është përcaktuar me planet e rregullta të monitorimit.

## **Neni 11**

Neni 31 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 31**

#### **Bashkëpunimi i Inspektoratit me institucionet tjera**

1. Inspektorati i tregut bashkëpunon me organet e tjera inspektuese përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, me qëllim të harmonizimit të metodave të punës, përpilimit të programit të mbikëqyrjes së tregut, dhe për shkëmbim të informacioneve në lidhje me produktet që paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë dhe ambientin apo çfarëdo interesi tjetër publik , në përputhje me ligjet e veçanta.

2. Inspektorati i tregut bën shkëmbimin e informacioneve dhe njoftimeve me prodhuesit, shpërndarësit dhe subjektet e tjera tregtare në përputhje me aktet e veçanta që rregullojnë sigurinë e produkteve.

3. Bashkëpunimi dhe procedura për shkëmbim të informacionit me Doganën e Kosovës, është e rregulluar me ligje të veçanta.

## **Neni 12**

Pas nenit 31 të ligjit bazik, shtohen nenet e reja 31.A, dhe 31.B me tekstin si në vijim:

### **Neni 31.A**

#### **Bashkëpunimi me autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të vendeve të treta**

Inspektorati i tregut, mund të bashkëpunoj me autoritetet për mbikëqyrjen e tregut të shteteve tjera, me qëllim të shkëmbimit të informacionit për produktet që paraqesin rrezik serioz për shëndetin, sigurinë dhe ambientin apo çfarëdo interesi tjetër publik .

### **Neni 31.B**

#### **Informimi i publikut**

1. Inspektorati i tregut është i obliguar që ta njoftojë publikun për përgjegjësitë, masat dhe veprimet e marra.

2. Njoftimi sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet përmes faqes zyrtare të internetit të inspektoratit të tregut ku paraqiten:

2.1. të dhëna se si mund të vëni kontakt me inspektoratin e tregut ;

2.2. për programin dhe raportin vjetor të punës së inspektoratit të tregut;

2.3. për ligjet dhe aktet nënligjore të cilat janë në fuqi ;

2.4. informacion për produktet e rrezikshme të vendosura në treg dhe masat e marra për të eliminuar rreziqet e paraqitura;

3. Me qëllim të veprimit parandalues, inspektorati i tregut, me kërkesën e bizneseve, do të japë udhëzime dhe sqarime për zbatimin e rregulloreve.

4. Inspektorati i tregut do të informojë publikun rreth të drejtave të konsumatorit, dhe me kërkesë të tyre do të jap edhe këshilla.

### **Neni 13**

Neni 33 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 33**

#### **Dispozitat ndëshkuese**

1. Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim:

1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik.

1.2. me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900)Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik.

1.3. me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) Euro, ndëshkohet personi fizik.

### **Neni 14**

Neni 34 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 34**

1. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 25 të ligjit bazik dhe nenit 9 të këtij ligji.

2. Me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 25 të ligjit bazik dhe nenit 9 të këtij ligji.

3. Me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) Euro, ndëshkohet personi fizik.

### **Neni 15**

Neni 36 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 36**

1. Me gjobë prej 2.000 (dymijë) deri në gjashtëmijë (6.000) Euro, ndëshkohet personi juridik i cili pengon sekuestrimin e produkteve të përcaktuar në nenin 17 paragrafi 1 të ligjit bazik.
2. Me gjobë prej treqind (300) deri në nëntëqind (900) Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 17 paragrafi 1. të ligjit bazik.
3. Me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) Euro, ndëshkohet personi fizik

### **Neni 16**

Pas nenit 36 të ligjit bazik, shtohet nen i ri 36.A me tekstin si në vijim:

### **Neni 36.A**

1. Në rast se subjekti i mbikëqyrur nuk bën ekzekutimin e gjobës brenda afatit të dhënë me aktvendim, inspektori mund të inicioj procedurë kundërvajtëse në gjykatën kompetente brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm.
2. Inspektori ka të drejtë të inicioj edhe procedura tjera administrative për ekzekutimin e gjobës, kur kjo është e përcaktuar me ligj të veçantë.

### **Neni 17**

### **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-186**  
**11 prill 2013**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-019-2013, datë 29.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës**  
**Atifete Jahjaga.**